V E N D I M
Nr. 182, datë 25.4.1995

PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 21, datë 13.1.1997; nr. 307, datë 19.5.1998; nr. 511, datë 30.7.2004; nr. 56[1], datë 28.1.2005; nr. 708, datë 16.11.2005)

(i përditësuar)

Në bazë të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat" dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. *Shfuqizuar.*
2. *Shfuqizuar.*
3. *Shfuqizuar.*
4. Çmimet e shitjes reference të barnave të listës kryesore shërbejnë si kufij maksimalë në llogaritjen e masës së rimbursimit të çmimeve të barnave të kësaj liste dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha farmacitë e rrjetit të hapur.

Farmacitë i afishojnë në vende të dukshme çmimet e shitjes së barnave për popullsinë sipas emërtesës së listës kryesore, si dhe listën e barnave thelbësore.

4.1 Barnat që hidhen në treg dhe qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, kanë të vendosur mbi kutinë e ambalazhit një pullë, për efekt kontrolli, si provë e regjistrimit të tyre, e marrjes së autorizimit për hedhjen e tyre në treg dhe për respektimin e çmimit përfundimtar të shitjes. Pulla e kontrollit i jepet subjektit fabrikues të barnave në Republikën e Shqipërisë ose subjektit shitës me shumicë të barnave nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, kundrejt pagesës, për çdo seri të barit të fabrikuar në vend ose të importuar.

a) Pulla e kontrollit përmban në mënyrë të detyrueshme këto të dhëna:

- emërtimin e barit;

- formë-dozën;

- serinë e prodhimit të barit;

- emrin e fabrikuesit/të importuesit të barit në Republikën e Shqipërisë;

- çmimin e shitjes me pakicë të barit;

- emërtimin e autoritetit që lëshon pullën: Qendra e Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

Katër nënpikat e para të shkronjës "a" mund të shprehen në mënyrë të shifruar, me përjashtim të dy nënpikave të fundit, të cilat duhen shprehur me fjalë.

---

[1] *VKM nr. 56, datë 28.1.2005 në pikat 1, 2, 3 dhe 4 shprehet;*

"1. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes së barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke llogaritur një marzh deri në 20 për qind mbi koston e prodhimit.

2. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave të importuara nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke llogaritur një marzh deri në 18 për qind mbi çmimin CIF, në lekë, të konvertuar sipas kursit mesatar, të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor. Për barnat e prodhuara në vend ky kufi llogaritet mbi çmimin EXW. Marzhi 18 për qind të ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht, 12.5 për qind dhe 5.5 për qind.

3. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me pakicë të barnave është 33 për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.

4. Për disa barna të listës që, me vendim të Këshillit të Ministrave, rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave."

b) Pulla e kontrollit vendoset prej subjektit fabrikues të barnave dhe subjektit shitës me shumicë të barnave mbi kutinë ambalazhuese të barit. Ajo i referohet deklarimit të fabrikuesit ose shitësit me shumicë të barit dhe autorizimit për hedhjen në treg, për çdo seri të veçantë.

c) për barnat, që janë gjendje në farmacitë e tregtimit me pakicë dhe që ende nuk janë pajisur me pullë kontrolli, pulla do të përmbajë vetëm këto të dhëna, në ndryshim me ato të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike:

- Emërtimin e autoritetit që lëshon pullën: Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave;

-Emrin e farmacisë së tregtimit me pakicë, e cila i disponon këto barna;

-Rrethin ku ndodhet famacia, e cila i disponon këto barna:

- Çmimi i barit, i cili plotësohet nga vetë tregtuesit e tregtimit me pakicë, sipas marzheve të miratuara për këtë qëllim.

Dy nëndarjet e para të shkronjës "c" mund të paraqiten edhe në mënyrë të shifruar.

Në këtë rast, pulla e kontrollit vendoset nga vetë farmacitë e tregtimit me pakicë të barnave.

4/2. Hedhja në treg, shitja me shumicë dhe me pakicë e barnave nga subjektet pa pullën e kontrollit përbën shkelje të rregullave të fabrikimit e të tregtimit dhe ndëshkohet sipas neneve 53 e në vijim, të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 "Për barnat", të ndryshuar.

4/3. Barnat e hedhura në treg dhe që janë në qarkullimin brenda 90 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të pajisen me pullën e kontrollit. Për barnat, gjendje në farmacitë e tregtimit me pakicë, në pullën e kontrollit të të cilave do të shënohen të dhënat e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 4. 1, afati i pajisjes me pullën e kontrollit të jetë data 31 dhjetor 2005.

5. Miratohet lista e barnave thelbësore sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor rimburson 100 për qind recetat për barnat thelbësore për fëmijët 0-12 muaj, për invalidët e Luftës, për invalidët e grupit të I-II për sëmundjet për të cilat kanë dalë invalidë, për kurimin e TBC-së dhe të kancerit sipas listës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe rimburson 50 për qind recetat për invalidët e grupit III-IV për sëmundjet për të cilat kanë dalë invalidë.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit cakton listën e barnave thelbësore të nevojshme për kurimin e sëmundjeve të TBC-së dhe të kancerit.

7. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ka kompetencë që gjatë vitit të bëjë ndryshime në strukturën e çmimeve të barnave të listës kryesore sipas pikës 3 të këtij vendimi.

7.1 Bazat grosiste të barnave të vënë në dispozicion të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe degëve të tij në rrethe informacion për çmimin e blerjes e të shitjes së barnave dhe sasinë e tyre. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor përcakton afatin e dërgimit të këtij informacioni dhe e kontrollon atë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.17, datë 24.1.1994 "Për ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të barnave dhe vendosjen e kufijve maksimalë të shitjes së tyre nga subjektet private", nr.483, datë 29.8.1994 "Për vendosjen e kufijve maksimalë të çmimit të shitjes së barnave nga subjektet private", nr.525, datë 17.10.1994 "Për subvencionimin nga shteti të barnave thelbësore", nr.51, datë 23.1.1959, pika 3 "Për masat për uljen e mëtejshme të vdekjeve në fëmijët e moshës së gjirit", nr.83, datë 16.3.1983, pika 2 "Për uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të disa barnave të vendit dhe të importit", nr.247, datë 27.5.1993 "Për subvencionimin nga shteti të një pjese të faturës së shpenzimeve për preparatet mjekësore të nevojshme për mjekimin e invalidëve", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi